



TREGU I PUNËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË DHE NË VENDET NË RAJON

INFORMATOR KRAHASUES



WESTMINSTER
FOUNDATION FOR
DEMOCRACY

Projekt:

“Mbështetje për reformën parlamentare të Maqedonisë”

Zbatuesi:

Fondacioni Westminster për Demokraci (Maqedoni)

Autor:

Petar Trajkov

Janar, 2018



Ky produkt është përgatitur në suaza të projektit “Mbështetje për reformën parlamentare të Maqedonisë”, financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me përkrahje të Ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë përmbajtje nuk i pasqyrojnë gjithmonë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë Britanike.



WESTMINSTER
FOUNDATION FOR
DEMOCRACY

TREGU I PUNËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË DHE NË VENDET NË RAJON

INFORMATOR KRAHASUES

Shkup, Janar 2018

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
1. AKTIVITETI I POPULLSISË	5
1.1. KRAHASIMI I FUQISË PUNËTORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË ME VENDET E RAJONIT	11
2. RROGAT	12
2.1. RROGA MESATARE NETO DHE BRUTO NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË NGA VITI 2010 DERI MË SOT (SHUMA DHE SHKALLA VJETORE E NDRYSHIMIT)	12
2.2. KRAHASIMI I RROGAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË ME VENDET E RAJONIT	15
LISTA E BURIMEVE	18

HYRJJE

Tema e këtij informatori është një përmbledhje sasiore e treguesve themelor social në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë, krahasuar me disa nga vendet e rajonit. Indikatorët që shfaqen në këtë punë hulumtuese janë:

1. **Aktiviteti i popullsisë**, ku janë paraqitur të dhënat për popullsinë e aftë për punë sipas aktivitetit ekonomik, gjinisë dhe përgatitjes shkollore, si dhe shkallës së punësimit dhe papunësisë;
2. **Rrogat**, indikator në të cilin janë përpunuar të dhënat për rrogat mesatare neto dhe bruto.

Të dhënat e përdorura në rishikimin sasior merren nga raportet zyrtare, njoftimet dhe buletinet e Entit Shtetëror për Statistikë të Republikës së Maqedonisë dhe institucionet relevante nga vendet, të dhënat e të cilave janë mjet krahasimi, pastaj Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Financave e Maqedonisë dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Informatori krahasues gjithashtu përmban përlogaritjet vetanake të autorit.¹

1. AKTIVITETI I POPULLSISË

Kur rishikojmë indikatorët e aktivitetit të popullsisë, është e nevojshme të japim përkufizime të caktuara që do të na ndihmojnë t'i kuptojmë më lehtë. Së pari, **popullsia e aftë për punë** përbëhet nga të gjithë personat e moshës 15 deri në 79 vjeç, ndërsa **popullsia ekonomikisht aktive** përbëhet nga të punësuarit dhe të papunët² (forca e punës). Indikatorët kryesorë për monitorimin e ndryshimeve në fuqinë punëtore janë:

- **Shkalla e aktivitetit** si pjesëmarrje në fuqinë punëtore në popullsinë e moshës së punës prej 15 vjeç e lart;
- **Shkalla e punësimit** si pjesëmarrje në fuqinë punëtore në popullsinë e moshës së punës prej 15 vjeç e lart;
- **Shkalla e papunësisë** si pjesë e numrit të të papunëve në totalin e fuqisë punëtore.


Përkufizimet e tilla të dhëna për fuqinë punëtore gjithashtu vlejné edhe për shtetet e tjera në analizën krahasuese.

¹ Faqja zyrtare e Entit Shtetëror të Statistikave të Republikës së Maqedonisë; qasur më 4.12.2017
<http://www.stat.gov.mk/PrikaziSooopstenie.aspx?rbtxt=98>

² Të punësuarit janë persona nga mosha 15 deri në 79 vjeç, të cilët: - gjatë javës raportuese kanë punuar për para (me para në dorë ose në natura) ose për fitim, të paktën 1 orë; - gjatë javës së raportimit përkohësisht (dmth. për shkak të sëmundjes, mungesës, studimeve, ndërprerjes së veprimtarisë së subjektit afarist, etj) Kanë munguar nga vendi i punës, por kanë qenë formalisht të punësuar; - kanë ndihmuar në pronën e familjes ose në ndërmarrjen familjare pa rrogë. **Personat e papunë** janë persona që plotësojnë tri kushtet si vijon: - gjatë javës raportuese nuk kanë punuar (sipas kritereve të mësipërme); - kanë kërkuar punë në mënyrë aktive, dmth. kanë ndërmarrë aktivitet konkret për të gjetur punë; - kanë qenë të gatshëm të praninin punën në dy javët e ardhshme pas javës së raportimit.

Tabela 1: Popullsia aktive dhe shkalla e aktivitetit në Republikën e Maqedonisë³

	Popullsia e aftë për punë	Popullsia aktive			Shkalla e aktivitetit		
		Gjithsej	Të punësuar	Të papunësuar	Shkalla e aktivitetit	Shkalla e punësimit	Shkalla e papunësisë
2010	1,648,522	938,294	637,855	300,439	56.9	38.7	32.0
2011	1,656,215	940,048	645,085	294,963	56.8	38.9	31.4
2012	1,669,965	943,056	650,554	292,502	56.5	39.0	31.0
2013	1,672,460	956,057	678,838	277,219	57.2	40.6	29.0
2014	1,673,494	958,998	690,188	268,810	57.3	41.2	28.0
2015	1,676,659	954,924	705,991	248,933	57.0	42.1	26.1
2016	1,678,890	948,599	723,550	225,049	56.5	43.1	23.7
2017 K-1	1,679,462	952,644	734,043	218,601	56.7	43.7	22.9
2017 K-2	1,679,525	955,699	739,892	215,807	56.9	44.1	22.6



Grafiku 1: Popullsia aktive dhe shkalla e aktivitetit në % në Republikën e Maqedonisë

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i Republikës së Maqedonisë

Nga të dhënat e prezantuara, është e dukshme një tendencë e rritjes së vazhdueshme të shkallës së punësimit, e cila në 2010 ishte 38.7%, që të rritej në 44.1% në tremujorin e dytë të vitit 2017, që është shkalla më e lartë e punësimit në periudhën e analizuar. Nga ana tjetër, shkalla e papunësisë shënon rënie në mënyrë të vazhdueshme gjatë periudhës së analizuar **dhe në vitin 2010 ishte më e larta dhe arriti në 32%, në tremujorin e dytë të vitit 2017 arriti nivelin më të ulët prej 22.6%**, që është rënie me pothuajse 10% krahasuar me vitin 2010. Shkalla e aktivitetit gjatë gjithë periudhës së analizuar shkon rreth 57%.

Shkaktarët kryesor për këtë situatë me zvogëlimin e papunësisë përmenden politikat aktive të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në periudhën e analizuar, kjo para së gjithash është tërheqja e investimeve të huaja dhe krijimin e vendeve të punës, por natyrisht qasja metodologjike e Entit Shtetëror të Statistikës, i cili i konsideron si punonjës edhe personat që kanë punuar së paku një orë në javën e raportimit, pastaj fshirjen nga lista e të papunëve përfituesit e subvencioneve, të cilët sipas ndryshimeve ligjore janë të detyruar të paguajnë dhe kontribute. Njëkohësisht, disa ekspertë theksojnë emigrimin e të rinjve si një nga arsytet për këtë rënie të papunësisë.⁴


³ Faqja zyrtare e Entit Shtetëror për Statistika e Republikës së Maqedonisë dhe Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë.

⁴ Radio Evropa e Lirë; Gjinnastikë statistikore me papunësinë, shtator 2015
<https://www.slobodnaevropa.mk/a/27253503.html>

Tabela 2: Popullsia aktive sipas gjinisë dhe përgatitjes së shkollës, tremujori i dytë 2017 krahasuar me vitin 2016⁵

Popullsia aktive sipas përgatitjes shkollore												
Përgatitja shkollore	Popullsia aktive				Të punësuar				Të papunësuar			
	II 2016	II 2016	II 2017	II 2017	II 2016	II 2016	II 2017	II 2017	II 2016	II 2016	II 2017	II 2017
Gjithsej	948,377	100%	955,699	100%	720,674	100%	739,892	100%	227,702	100%	215,807	100%
Arsim fillor	181,293	19%	158,569	17%	123,520	17%	117,744	16%	57,773	25%	40,824	19%
4 vjet shkollim të mesëm	427,471	45%	468,363	49%	327,931	46%	354,960	48%	99,540	44%	113,403	53%
Arsim të lartë	216,614	23%	225,535	24%	170,947	24%	181,670	25%	45,667	20%	43,865	20%
Gjithsej Burra	587,825	62%	583,795	61%	443,920	62%	450,028	61%	143,905	63%	133,766	62%
Arsim fillor	127,823	13%	108,146	11%	84,195	12%	75,593	10%	43,629	19%	32,552	15%
4 vjet shkollim të mesëm	275,868	29%	300,169	31%	211,144	29%	226,452	31%	64,724	28%	73,717	34%
Arsim të lartë	104,432	11%	105,871	11%	84,188	12%	90,635	12%	20,244	9%	15,236	7%
Gjithsej Gra	360,552	38%	371,904	39%	276,755	38%	289,864	39%	83,797	37%	82,041	38%
Arsim fillor	53,469	6%	50,423	5%	39,325	5%	42,151	6%	14,144	6%	8,272	4%
4 vjet shkollim të mesëm	151,602	16%	168,194	18%	116,787	16%	128,508	17%	34,815	15%	39,686	18%
Arsim të lartë	112,182	12%	119,665	13%	86,759	12%	91,036	12%	25,423	11%	28,629	13%

*Në tabelë janë paraqitur vetëm nivele të caktuara të përgatitjes së shkollës, të cilat janë më të pranishme në sistemin në Republikën e Maqedonisë.




Grafiku 2: Popullsia aktive, gjithsej sipas gjinisë, tremujori i dytë 2017 krahasuar me vitin 2016

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i Republikës së Maqedonisë

⁵ Ueb Faqja zyrtare e Entit Shtetëror të Statistikave të Republikës së Maqedonisë; Anketë për fuqinë punëtore në Republikën e Maqedonisë, tremujori i dytë 2017, i qasur më 4.12.2017

<http://www.stat.gov.mk/PrikaziSooptenie.aspx?rbtxt=98>




Grafiku 3: Popullsia aktive, gjithsej sipas gjinisë, tremujori i dytë 2017 në %
Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i Republikës së Maqedonisë

Ajo që është indikative të vërehet në grafikun e paraqitura është se numri i **meshkujve aktivë të aftë për punë është shumë më i madh se gratë aktive të afta për punë, duke përbërë 61%, ndërsa te gratë është 39%**. Ngjashëm është edhe situata me shkallën e punësimit, gjegjësisht papunësia, e cila është rreth 60% për burrat, d.m.th, rreth 40% në femra. Situata është krejt e ndryshme kur është fjala për **popullsinë joaktive**, e cila nuk përfshihet në fuqinë punëtore dhe **këtu burrat marrin pjesë me 35%, ndërsa gratë me 65%**, e cila është kryesisht për shkak të përgjegjësiwe familjare dhe obligimeve shtëpiake, në të cilën është e përfshirë gruaja, dmth. vlerat tradicionale në shoqëri.⁶




Grafiku 4: Popullsia aktive sipas gjinisë dhe përgatitjes shkollore sipas gjinisë, krahasuar me vitin 2017

⁶ Nikica Mojsoska-Blazhevski dhe Enti Shtetëror i Statistikave të Maqedonisë, International labor Organization, Kalimi i grave dhe burrave të rinj në tregun e punës në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë; Qershor 2016, f. 30
http://embargo.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_emp/documents/publication/wcms_524997.pdf




Grafiku 5: Popullsia aktive sipas përgatitjes shkollore dhe sipas gjinisë, tremujori i dytë 2017/2016 (ndryshim në%)



Grafiku 6: Popullsia aktive sipas përgatitjes shkollore dhe sipas gjinisë, tremujori i dytë 2016 në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2017

Burimi: Enti Shtetëror për Statistika i Republikës së Maqedonisë




Grafiku 7: Popullsia aktive sipas përgatitjes shkollore sipas 2017

Sa i përket aktivitetit të popullsisë sipas përgatitjes shkollore është e qartë se në totalin e fuqisë punëtore, më e madhe është pjesëmarrja e personave me arsim të mesëm (3 dhe 4 vjet) me mbi 54%, që vijon nga personat me arsim të lartë me 23% dhe personat me arsim fillor me 19%. Pothuajse është e njëjtë përqindja e përfaqësimit në punësim sipas përgatitjes shkollore, ndërsa në rastin e papunësisë është më e larta për njerëzit me arsim të mesëm të përfunduar (3 dhe 4 vjet) dhe është rreth 60%, ndërsa për personat me arsim fillor të përfunduar dhe arsim të lartë arrin deri në 20%.

1.1. KRAHASIMI I FUQISË PUNËTORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË ME VENDET E RAJONIT

Tabela 3: Fuqia punëtore gjithsej dhe sipas gjinisë, tremujori i II-të 2017 - Qasja rajonale⁷

Држава		Popullsia e aftë për punë	Popullsia aktive (fuqia punëtore)	Shkalla e aktivitetit	Të punësuar	Shkalla e punësimit	Të papunësuar	Shkalla e të papunësuarve
Maqedonia	Gjithsej	1,679,525	948,377	56%	739,892	44%	215,807	23%
	Burra	840,595	587,825	70%	450,028	54%	133,766	23%
	Gra	838,930	360,552	43%	289,864	35%	82,041	23%
Shqipëria*	Gjithsej	2,362,396	1,380,764	58%	1,189,231	50%	191,533	14%
	Burra			67%		57%		15%
	Gra			50%		43%		13%
Serbia*	Gjithsej	5,988,200	3,265,000	55%	2,881,000	48%	384,100	12%
	Burra			63%		56%		11%
	Gra			47%		41%		13%
Mali i Zi	Gjithsej	499,635	273,800	55%	230,800	46%	41,300	15%
	Burra	244,071	152,300	62%	130,000	53%	22,300	15%
	Gra	255,789	121,500	48%	102,500	40%	19,000	16%
Kroacia	Gjithsej	3,548,471	1,834,000	52%	1,633,000	46%	201,000	11%
	Burra	1,691,471	992,000	59%	890,000	53%	102,000	10%
	Gra	1,857,000	843,000	45%	743,000	40%	100,000	12%
Bulgaria	Gjithsej	6,076,054	3,385,600	56%	3,171,700	52%	213,900	6%
	Burra	2,820,660	1,805,300	62%	1,624,700	58%	123,900	7%
	Gra	3,157,627	1,580,400	50%	1,490,400	47%	90,000	6%
Greqia	Gjithsej	7,235,511	4,807,979	52%	3,791,408	52%	1,016,571	21%
	Burra	3,646,333	2,657,300	60%	2,187,800	60%	469,500	18%
	Gra	3,547,788	2,150,700	45%	1,603,600	45%	547,100	25%



Grafiku 8: Fuqia punëtore gjithsej - Qasja Rajonale

Burimi: Institucionet nacionale statistikore të shteteve

⁷ Njoftime nga tregu i punës i institucioneve statistikore nacionale të vendeve të analizuara
<http://www.stat.gov.mk/PrikaziSooopstanie.aspx?rbtxt=41>

*Në njoftimet zyrtare nuk përpunohen të gjithë informacionet.

Nga të dhënat e paraqitura në grafikë mund të shihet se shkalla e aktivitetit në të gjitha vendet shkon nga 52% në 58%. Shkalla më e ulët e aktivitetit është vërejtur **në Greqi dhe në Kroaci, ku forca e punëtore merr pjesë me 52% të popullsisë së përgjithshme të aftë për punë, ndërsa shkalla më e lartë e aktivitetit është në Shqipëri me 58%. Shkalla e punësimit është më e ulëta në Republikën e Maqedonisë, me 44%, e ndjekur nga Mali i Zi dhe Kroacia me shkallë punësimi prej 46%, pastaj Serbia me 48%, Shqipëria me 50% dhe Bullgaria, Greqia me shkallën më të lartë të punësimit prej 52%. Shkalla më e lartë e papunësisë është regjistruar në Republikën e Maqedonisë në masën 23%, pas së cilës vijon Greqia me 21%. Në vende të tjera, shkalla e papunësisë është nën 20%, në Mal të Zi, 15%, Shqipëri 14%, Serbi 12%, Kroaci 11% dhe Bullgaria me normën më të ulët të papunësisë prej 6%.**

2. RROGAT

2.1. RROGAT MESATARE NETO DHE BRUTO NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË NGA VITI 2010 DERI MË SOT (SHUMA DHE SHKALLA VJETORE E NDRYSHIMIT)

Nocioni i rrogës, nga pikëpamja ekonomike, paraqet pjesë nga prodhimi i përgjithshëm, i cili u kthehet punonjësve si kosto e punës, në dallim nga kompensimi i fituar nga kapitali që përfaqëson të ardhurat kapitale. Rroga mesatare është masë që shpreh situatën financiare të banorëve të një vendi të caktuar.⁸

Sipas metodologjisë së Bankës Popullore të Maqedonisë, të dhënat mbi rrogat neto dhe bruto të paguara për çdo punonjës bazohen në raportet mujore të subjekteve afariste në pronësi private dhe të tjera (sociale, shtetërore, kooperative dhe të përziera) me aktivitete të ndryshme në Republikën e Maqedonisë, sipas të dhënave të përgatitura nga Enti Shtetëror i Statistikës i Republikës së Maqedonisë.

“Bruto rrogat të paguara në total përfshijnë: neto rroga të paguara për periudhën raportuese, tatim personal dhe kontribute të paguara për: sigurim pensional dhe invalidor, për sigurim shëndetësor, për punësim, për sëmundje profesionale. Neto rrogat e paguara në total përfshijnë: neto rroga të paguara për muajin raportues për punën për orar të plotë, më shkurtë se orari i rregullt dhe më i gjatë se orari i plotë (punë jashtë orarit të punës), kompensime të neto rrogës nga mjetet e subjektit afarist për pushim vjetor, festa shtetërore, mungesë e paguar prej shtatë ditë, mungesë e paguar për arsim profesional, për pushim mjekësor deri në 21 ditë dhe ngjashëm, kompensime të neto rrogës në barë të punëdhënësve të tjerë për kohë të kaluar në trajnim me ftesë të organit shtetëror kompetent, mbrojtje civile dhe ngjashëm.”⁹


⁸ Burimi: Internet faqja zyrtare e Komisionit Evropian - Eurostat; e qasur më 1.10.2015.
http://epp.eurostat.ec.europa.eu/statistics_explained/index.php/Wages_and_labour_costs

⁹ Interet faqja zyrtare e Entit shtetëror të statistikës së Republikës të Maqedonisë nga data 2.10.2015.
<http://www.stat.gov.mk/MetodoloskiObjasSoop.aspx?id=41&rbrObl=14>


Tabela 4: Bruto dhe neto rrogat mesatare në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës nga viti 2010 deri më sot

	Bruto - rroga			Neto - rroga		
	Mesatare (Në denarë)	Ndryshimi nominal	Ndryshimi real*	Mesatare (Në denarë)	Ndryshimi nominal	Ndryshimi real*
2010	30,225			20,553		
2011	30,602	1.2	-2.6	20,847	1.4	-2.4
2012	30,669	0.2	-3.0	20,902	0.3	-2.9
2013	31,025	1.2	-1.6	21,145	1.2	-1.6
2014	31,325	1.0	1.3	21,394	1.2	1.5
2015	32,173	2.7	3.0	21,906	2.4	2.7
2016	32,822	2.0	2.2	22,342	2.0	2.2
2017 K-1	33,104	2.3	1.8	22,514	2.2	1.7
2017 K-2	33,481	2.3	1.0	22,789	2.2	1.0
I 2017	33,441	2.4	1.8	22,750	2.2	1.6
II	32,869	2.5	2.3	22,347	2.4	2.2
III	32,999	1.9	1.3	22,445	1.8	1.2
IV	33,296	1.5	0.5	22,672	1.4	0.4
V	33,640	2.6	1.4	22,889	2.5	1.3
VI	33,509	2.7	1.2	22,808	2.8	1.3
VII	33,328	1.5	0.3	22,671	1.5	0.3
VIII	33,675	2.7	0.8	22,912	2.8	0.9

*Ndryshimi real e përfshin shkallën e inflacionit për vitin rrjedhës



Grafiku 9: Bruto dhe neto rroga mesatare në Republikën e Maqedonisë për periudhën nga viti 2010 deri më sot



Grafiku 10: Ndryshim nominal dhe real në % të neto dhe bruto rrogave mesatare në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës nga viti 2010 deri më sot


Nga ilustrimet e të dhënave më lartë mund të vërehet se ekziston trend i rritjes së butë të bruto dhe neto rrogave në Republikën e Maqedonisë nga viti 2010 deri më sot në shumë absolute, ashtu që bruto rrogat prej 30.225 denarë në vitin 2010 u rritën në 33.481 në tremujorin e dytë të 2017-ës, ndërsa neto vlera e rrogave nga 20.553 në vitin 2010 u rrit në 22.789 denarë në tremujorin e dytë të 2017-ës. Nga ana tjetër, **ndryshimi real nuk është çdo herë pozitiv**, në veçanti kur shprehet për periudhën prej vitit 2011 deri në vitin 2013, gjatë kohës së krizës botërore ekonomike, kur ndryshimi real i bruto rrogave u ul deri në -3.0% në vitin 2012, ndërsa nga ana tjetër, për vitin e njëjtë ndryshimi real i neto rrogave ka qenë -2.9%.

2.2. KRAHASIMI I RROGAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË ME VENDET E RAJONIT

Tabela 5: Bruto dhe neto rrogat mesatare në Republikën e Maqedonisë edhe në vendet e rajonit

Држава	Bruto rroga minimale (Euro në muaj ¹⁰) p2	Bruto rroga në valutë nacionale	Neto rrogë në valutë nacionale	Bruto - rroga në Euro	Neto - rroga në Euro	Bruto rroga minimale Euro/bruto rroga Euro	Bruto rroga minimale Euro/neto rroga Euro
Shqipëria ***	163	45,845 ALL	38,650 ALL	343	290	47%	56%
Bullgaria***	235	1,064 BGN	830 BGN	544	424	43%	55%
Maqedonia*	240	34,127 MKD	23,229 MKD	555	378	43%	64%
Serbia*	248	66,438 RSD	48,212 RSD	555	403	45%	62%
Mali i Zi*	288	767 EUR	511 EUR	767	511	38%	56%
Greqia**	683	1,092 EUR	917 EUR	1,092	917	63%	74%
Kroacia*	433	7,989 HRK	5,958 HRK	1,059	790	41%	55%

*Të dhënat për neto / bruto rrogat mesatare për këto vende janë për shtator 2017
 ** Të dhënat për neto / bruto rrogat mesatare për këto vende janë për prill 2017
 *** Të dhënat për neto / bruto rrogat mesatare për këto vende janë për vitin 2016
 ****Të dhënat e përlogaritura janë të përafërta për shkak të ndryshimeve të caktuara metodologjike dhe për shkak të dallimeve në kursin e devizave në ditën e përlogaritjes
 Neto rrogat për Bullgarinë, Greqinë dhe Shqipërinë janë përlogaritje e autorit
 Të dhënat për bruto rrogat minimale për këto vende janë për gjysmë vjetorin e parë të vitit 2017



Grafiku 11: Bruto dhe neto rrogat në Republikën e Maqedonisë dhe në vendet e rajonit në euro

Burimi: Institucionet nacionale për statistikë të vendeve përkatëse

¹⁰ Faqja zyrtare e internetit të Eurostat
http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=earn_mw_cur&lang=en

Organizata Ndërkombëtare e Punës (**International Labor Organization**) e përkufizon nocionin rrogë minimale si: “Shuma minimale e cila i paguhet punëtorit për punën e bërë ose shërbimin e ofruar për periudhë të caktuar, të përlogaritur në bazë të kohës ose mbi autputin. Rroga minimale është e garantuar me ligj dhe është e përcaktuar në mënyrë që ti mbulojë nevojat minimale të punëtorit dhe familjes së tij ose saj, në lidhje me kushtet nacionale ekonomike dhe sociale”¹¹.

Sipas raportit të Eurostat për gjysmë vjetorin e parë të vitit 2017, në lidhje me bruto rrogat minimale në vendet e analizuara, është vërejtur se **Shqipëria ka bruto rrogë më të ulët minimale dhe ajo është 163 euro**, ndërsa, në **Greqi bruto rroga minimale është më e lartë nga vendet e analizuara dhe është 683 euro në muaj**. E ngjashme është gjendja edhe me bruto rrogën mujore mesatare, e cila më e ulët është në **Shqipëri me shumë prej 343 euro në muaj, ndërsa, në Greqi është më e larta me shumë prej 1.092 euro** në muaj. Menjëherë pas Greqisë vijon Kroacia me 1.059 euro bruto rrogë mesatare mujore, pastaj Mali i Zi me 767 euro, pastaj vijon Serbia dhe Maqedonia me bruto rrogë mesatare prej 555 euro, dhe Bulgaria me 544 euro. **Neto rroga mesatare mujore më e lartë paguhet në Greqi me shumë prej 917 euro, ndërsa më e ulëta në Shqipëri, me shumë prej 290 euro.**

Tabela 6: Personat e punësuar dhe bruto rrogat mesatare në Euro sipas sektorëve të veprimtarisë¹² në Republikën e Maqedonisë dhe në vendet e rajonit

Vendi	Të punësuar në bujqësi	% nga gjithsej	Bruto rroga mesatare në bujqësi (Euro)	Të punësuar në industri	% nga gjithsej	Bruto rroga mesatare në industri (Euro)	Të punësuar në veprimtari shërbyese	% nga gjithsej	Bruto rroga mesatare në veprimtari shërbyese (euro)
Shqipëri*			248			346			391
Maqedoni	120,304	16	440	226,132	31	604	393,456	53	624
Serbi**	34,000	2	499	605,000	30,2	666	1,367,000	68	607
Mali i Zi	18,300	7,9	819	41,400	17,8	819	172,800	74,3	799
Greqia	457,000	12		581,000	15		2,753,333	73	
Kroacia	111,000	6,8	908	434,000	26,6	1159	1,085	66,5	1,120


Të dhënat për të punësuarit janë për tremujorin e dytë të vitit 2017

*Të dhënat për rrogë janë për shtator 2017

** Të dhënat janë për vitin 2016


¹¹ Sistemi i rrogave minimale, Konferenca ndërkombëtare e punës, seria nr.103, 2014, faq. 50, [http://www.ilo.org/public/libdoc/ilo/P/09661/09661\(2014-103-1B\).pdf](http://www.ilo.org/public/libdoc/ilo/P/09661/09661(2014-103-1B).pdf)

¹² Klasifikimi nacional i veprimtarive - KNV Rev. 2 është klasifikim i veprimtarive ekonomike në Republikën e Maqedonisë e cila përdoret për grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave statistikore, si dhe për analiza dhe udhëzimin e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, si dhe ndryshimet e tyre strukturore. Gjithashtu, klasifikimi përdoret për shpërndarjen e subjekteve afariste (persona juridikë dhe fizikë) sipas veprimtarisë së tyre, mbajtjes së regjistrave të biznesit dhe për qëllime të tjera administrative. Klasifikimi i veprimtarive ka 21 sektorë, 88 seksione, 272 grupe, 615 klasa dhe 4 nënklasa. Qëllimi kryesor i Klasifikimit të veprimtarive është të sigurojë bazë për zbatimin e të dhënave statistikore të Republikës së Maqedonisë në nivel Evropian dhe botëror. NACE Rev. 2. (Regulation (EC) No.1893/2006)



Grafiku 12: Bruto rroga për sektorë në vendet e rajonit, 2017 (në euro)

Burimi: Njoftime zyrtare të institucioneve nacionale statistikore



Grafiku 13: Punësimi nëpër sektorë në vendet e rajonit në % në vitin 2017

Burimi: Njoftimet zyrtare të institucioneve nacionale statistikore

Nga informatat e qasshme në vendet e rajonit, të cilat janë në lidhje me të punësuarit nëpër sektorë të veprimtarive, kudo vërehet prezenca e madhe e **të punësuarve në sektorin e veprimtarive shërbyese (gjithsej 15 sektorë)¹³, edhe atë në Malin e Zi është 74%**, nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, pastaj 73% në Greqi, 68% në Serbi, 66% në Kroaci dhe më pak të punësuar në sektorët e shërbimit ka në Maqedoni, gjithsej 53%. Për dallim nga sektorët e shërbimit, **në Maqedoni numri i të punësuarve në bujqësi është më i lartë në raport me vendet e analizuar dhe kap shifrën prej 16%**, pas asaj vijojnë Greqia me 12%, Mali i Zi 8%, Kroacia me 7% dhe Serbia me vetëm 2% të punësuar në sektorin bujqësi. Në

¹³ Shërbimet të tregtisë me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve motorike dhe motoçikletave; Shërbime për transport dhe magazinim; Shërbime për akomodim dhe shërbime shërbyese me ushqim; Shërbime për informacione dhe komunikime; Shërbime financiare dhe shërbime për sigurim; Shërbime me pronë të patundshme; Shërbime profesionale shkencore dhe teknike; Shërbime administrative dhe ndihmëse; Shërbime në administratën publike dhe mbrojtje; Shërbime për sigurim të detyrueshëm social; Shërbime në arsim; Shërbime në mbrojtjen shëndetësore dhe sociale; Shërbime për art, argëtim dhe rekreacion; Shërbime të tjera; Shërbime për ekonomitë familjare si punëdhënës; Shërbime për ekonomitë familjare që prodhojnë produkte të ndryshme dhe kryejnë shërbime të ndryshme për nevojat vetjake; Shërbime për organizata dhe trupa eksterritoriale.

industri në të cilën bëjnë pjesë **gjithsej 5 sektorë**¹⁴, më shumë të punësuar ka në **Maqedoni 31%**, pastaj në Serbi me 30%, Kroaci 27%, Mal të Zi 18% dhe Greqi me 12% të punësuar në industri. Sa i përket bruto rrogave mesatare nëpër sektorë, mund të konstatohet se ato janë më të ulëta në **bujqësi**, dhe kjo pothuajse në të gjitha vendet, përveç në Mal të Zi. Ato lëvizin prej **248 euro në Shqipëri**, pastaj 440 euro në Maqedoni, 499 euro në Serbi, 819 uro në Mal të Zi dhe **908 euro në Kroaci**. Nga ana tjetër, bruto rrogat mesatare në industri dhe në sektorin e shërbimeve janë pothuajse të barazuara në të gjitha vendet dhe ato lëvizin prej **346 euro në industri, respektivisht 391 euro në veprimtaritë e shërbimit në Shqipëri, deri në 1.116 euro në industri, respektivisht 1.121 euro në sektorin e shërbimit në Kroaci**.

LISTA E BURIMEVE

1. Faqja zyrtare e Entit Shtetëror të Statistikës të Republikës së Maqedonisë
<http://www.stat.gov.mk/MetodoloskiObjasSoop.aspx?id=41&rbrObl=14>
2. Internet faqja zyrtare e Komisionit Evropian, Eurostat
http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=earn_mw_cur&lang=en
3. Internet faqja zyrtare e Bankës Botërore
<http://databank.worldbank.org/data/views/variableselection/selectvariables.aspx?source=global-economic-prospects;>
4. Ministria e Financave të Republikës së Maqedonisë
<http://www.finance.gov.mk/>
5. Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, Raport tremujor i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, tremujori II, 2017
<http://www.nbrm.mk/ns-newsarticle-kvartalen-izvestaj-statisticki-prilog-2017.nspk>
6. Internet faqja zyrtare e OECD Economic Outlook (database)
<https://stats.oecd.org/Index.aspx?DataSetCode=RMW>
7. Internet faqja zyrtare e Entit Shtetëror të Statistikës së Malit të Zi
<http://www.monstat.org/eng/page.php?id=1398&pageid=22>
8. Internet faqja Zyrtare e Institutit për Statistikë të Shqipërisë
http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__TP__LFS__LFSQ/
9. Internet faqja zyrtare e Entit Republikan për Statistikë të Republikës së Serbisë
<http://webrzs.stat.gov.rs/WebSite/Public/PageView.aspx?pKey=61>
10. Internet faqja zyrtare e Entit Republikan për Statistikë të Republikës së Greqisë
<http://www.statistics.gr/en/statistics/-/publication/SJO01/->
11. Internet faqja zyrtare e Institutit për Statistikë të Bullgarisë
http://www.nsi.bg/sites/default/files/files/pages/KeyInd_e/KeyInd2017-10_en.pdf
12. Organizata Ndërkombëtare e Punës
<http://www.ilo.org/travail/areasofwork/wages-and-income/lang--en/index.htm>
13. Internet faqja zyrtare e Entit Statistikor të Kroacisë
https://www.dzs.hr/default_e.htm
14. Internet faqja zyrtare trading economics
<https://tradingeconomics.com/>

¹⁴ Xehetari dhe nxjerrja e gurit; Produkte të industrisë përpunuese; energji elektrike, gaz, avull dhe klimatizim; Furnizimi me ujë; Mënjanimin e ujërave të zeza; Menaxhim me mbetje dhe veprimtari për sanimin e mjedisit; Objekte ndërtimore dhe punë ndërtimore.

